



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 15 tetor 2010
Ref. Nr.: RK 47/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti Nr. KI 14/09

Trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës

kundër

Vendimit Nr. PKL. Nr. 21/07 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, i datës 17 dhjetor 2008

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Ivan Cukalovic, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtare dhe
Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Duke u bazuar në parashtresat, Parashtruesit:

- | | |
|-------------------------|-----------------------|
| (1) Xhafer Loxha, | (10) Agim Loxha, |
| (2) Nezije Koro, | (11) Nexhmedin Loxha, |
| (3) Behide Elshani, | (12) Behixhe Loxha, |
| (4) Myzafere Gacaferri, | (13) Aferdita Vokshi, |
| (5) Nexhdet Loxha, | (14) Xhavit Loxha, |
| (6) Zebra Broqi, | (15) Nekibe Jadrashi, |
| (7) Besim Kardesh, | (16) Nemide Hadri, |
| (8) Belkize Gjogoviqi, | (17) Resmije Peja and |
| (9) Atifete Loxha, | (18) Xhevdet Loxha |

janë trashëgimtarët e vëllezërve Ymer dhe Sehit Loxha, ish tregtarë nga Peja, dhe që përfaqësohen nga Adem Vokshi, avokat në Mitrovicë.

Vendimi i sfiduar

2. Në kërkesën e tyre, parashtuesit sfidojnë Vendimin Nr. PKL Nr. 21/07 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 17 dhjetor 2008.

Objekti i çështjes

3. Nëpërmjet vendimit të 17 dhjetorit 2008, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga parashtuesit kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të datës 10 janar 2007, me anë të të cilit u refuzua që para Gjykatës së Qarkut në Pejë të rihapet procedura penale e vitit 1945, ku vëllezërit Ymer dhe Sehit Loxha u shpallën armiq të popullit dhe, meqenëse ata kishin ikur në Shqipëri, atyre iu konfiskua prona dhe asetet në bazë të Ligjit për Konfiskimin e Pronës dhe Ekzekutimin e Konfiskimit (Gazeta Zyrtare e Federatës Demokratike të Jugosllavisë, NOAO/45 të 9 qershorit 1945).
4. Gjykata Supreme, po ashtu, gjeti që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte paraqitur nga persona të paautorizuar, në bazë të Nenit 453 (2) dhe Nenit 454 (2) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.
5. Parashtuesit ankohen që vendimi i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tyre për mjet juridik, siç garantohet me Nenin 32 të Kushtetutës, Nenin 2 (1) të Protokollit Nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nenin 14 (5) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Nenin 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

6. Kërkesa është bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Kushtetuta), Neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji"), dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Rregullorja e Punës").

Procedura para Gjykatës

7. Më 25 prill 2009, parashtuesit kanë paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Më 4 shkurt 2010, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Kadri Kryeziu (Kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami, e shqyrtoi raportin i Gjyqtarës Raportuese Gjylieta Mushkolaj dhe i rekomandoi Gjykatës në lidhje me papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet

8. Në bazë të dokumenteve të paraqitura nga përfaqësuesi ligjor i parashtuesve del që, në bazë të Vendimit K.K. Br.18/45, të datës 29 dhjetor 1945, Gjykata e Qarkut në Pejë ka vendosur 'të konfiskoje pronën e paluajtshme të armiqve të popullit dhe të ikurve nga autoritetet e popullit në Shqipëri, sipas Ligjit për Konfiskimin e Pronës dhe Ekzekutimin e Konfiskimit (Gazeta Zyrtare e Federatës Demokratike të Jugosllavisë, NO 40/45, i datës 9 qershor 1945).
9. Më 2006, parashtuesit, në cilësinë e trashëgimtarëve të Ymer dhe Sehit Loxhës, kanë paraqitur një kërkesë në Gjykatën Komunale në Pejë për rishikimin e

procedurës penale më 1945. Më 23 maj 2006, Gjykata Komunale nëpërmjet Vendimit KP.nr.5/05 ka refuzuar kërkesën në bazë të vlerësimit se procedura në fjalë nuk ishte e natyrës penale, por kishte të bënte me procedurën për konfiskimin e pronës në bazë të Ligjit për Konfiskimin e Pronës dhe Ekzekutimin e Konfiskimit të vitit 1945.

10. Për më shumë, Gjykata Komunale ka theksuar që është plotësisht e pabazë për t'u kërkuar rihapja e procedurës penale në lidhje me një vendim të gjykatës që është i bazuar në Ligjin për Konfiskimin e Pronës, dhe po ashtu ka nënvizuar që vendimi aktual është nxjerrë në pajtim me Nenin 445 (1) (2)¹ në lidhje me Nenin 438 të KPPPK.²
11. Përfaqësuesi ligjor i parashtresve paraqiti një ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, duke kontestuar vendimin "për shkak të shkeljeve thelbësore të rregullave procedurale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale". Në ankesë, Gjykatës së Qarkut iu propozua aprovimi si i bazuar i kërkesës për rihapje të procedurës penale dhe shpallja si e pavlefshme e Vendimit K.K.Br.18/45 të Gjykatës Komunale në Pejë, të datës 29 dhjetor 1945.
12. Nëpërmjet Vendimit Pn.Nr.74/06, të datës 10 janar 2007, Gjykata e Qarkut në Pejë refuzoi ankesën e parashtresve si të pabazë dhe konfirmoi vendimin e Gjykatës Komunale të datës 23 maj 2006. Gjykata theksoi që pretendimet ankimore kishin të bënin me natyrën diskriminuese të ligjeve në fuqi në atë kohë dhe që faktet e paarsyeshme, të përmendura në Vendimin K.K.Br.18/45, nuk mund t'i nënshtrohen rishikimit të përsëritur të procedurës penale. Për më shumë, këto pretendime do të mund të ishin të rëndësishme në rast të rivlerësimit të legjislacionit apo ligjeve në lidhje me konfiskimin e pronës nëpërmjet zbatimit të dispozitave dhe akteve të nacionalizimit, reformës agrare, konfiskimit, sekuestrimit, shpronësimit dhe dispozitave tjera që janë zbatuar pas 9 marsit 1945. Prandaj, sipas mendimit të Gjykatës, rivlerësimi i legjislacionit të asaj kohe kur Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Vendimin K.K.Br.18/45 "është një çështje e rivlerësimit ligjor për rikthimin e pronës së konfiskuar dhe e dëmshpërblimit të ish pronarëve, që është përgjegjësi e legjislaturës së Kosovës për të respektuar kushtet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore". Gjykata konstatoi që "Vendimi K.K.Br.18/45 nuk ka qenë një vendim penal pas përfundimit të procedurës penale, por një vendim deklarativ për konfiskimin e pronës që është nxjerrë në frymën e dispozitave të atëhershme, që do të thotë se kërkesa për rihapjen e procedurës penale është refuzuar me të drejtë".
13. Më 9 mars 2007, përfaqësuesi ligjor i parashtresve paraqiti një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme në Prishtinë, duke kontestuar Vendimin KP.Nr.5/05 të Gjykatës Komunale dhe Vendimin Pn.Nr.74/06 të Gjykatës së Qarkut, mbi bazën se këto vendime përbëjnë shkelje thelbësore të rregullave procedurale, vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Përfaqësuesi ligjor kërkoi që Gjykata Supreme të ndryshojë vendimet e kontestuara, t'u aprovojë parashtresve kërkesën për revizion të procedurës penale, dhe të shpallë të pavlefshëm Vendimin K.K.Br.18/45 të Gjykatës Komunale në Pejë, të datës 29 dhjetor 1945, dhe dënimet që burojnë nga ai.

¹ Neni 445.1.2 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (Rregullorja e UNMIK Nr. 2003/26): (1) Gjykata me aktvendim hedh kërkesën kur në bazë të saj dhe shkresave të procedurës së mëparshme vërteton se: 2) Nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës.

² Neni 438 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (Rregullorja e UNMIK Nr. 2003/26): Procedura penale e përfunduar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë, mund të rishikohet me kërkesën e personave të autorizuar vetëm në rastet dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod.

14. Në seancën e mbajtur më 17 dhjetor 2008, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit PKI.Nr.21/07, nuk aprovoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke theksuar që, në pajtim me Nenin 451.1 të KPPPK, "kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër një vendimi gjyqësor të formës së prerë në procedurë penale", dhe që "nga parashtresat del që Ymer dhe Sehit Loxha nuk iu kanë nënshtruar procedurës penale". Sipas mendimit të Gjykatës, Gjykata e Qarkut kishte të drejtë kur konstatoi se mjeti juridik për rishikimin e procedurave penale nuk parashihet për procedurat gjyqësore gjatë të cilave prona e një personi konfiskohet, apo kur ai/ajo nuk shpallet fajtor për ndonjë vepër penale. Për më shumë, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është paraparë as për vendimet gjyqësore ku ky dënim shqiptohet dhe për të cilin vendimi nuk merret në bazë të procedurës penale, dhe ku personi as nuk gjykohet e as nuk shpallet fajtor për ndonjë vepër penale.
15. Më tutje, Gjykata Supreme vendosi që Ymer dhe Sehit Loxha nuk kanë poseduar cilësinë e personave të dënuar dhe se as avokati i tyre nuk ka qenë në cilësinë e avokatit tyre mbrojtës, por që vetëm ishte përfaqësues i trashëgimtarëve të tyre. Sipas mendimit të Gjykatës, personat e autorizuar për të paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë janë Prokurori Publik i Kosovës, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës, dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur nga personi i paautorizuar dhe prandaj ishte e papranueshme, në mbështetje të neneve 453 (2) (2) dhe 454 (2) të KPPPK.

Pretendimet e parashtresve

16. Parashtresit tani ankohen se Gjykata Supreme u ka mohuar atyre të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për një mjet efektiv juridik, në kundërshtim me nenet 31 (2) dhe 32 të Kushtetutës dhe me dispozita të caktuara të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut³, duke mos i lejuar atyre nisjen e procedurave për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe që Gjykata nuk e ka interpretuar ligjin në mënyrë të drejtë. Ata pohojnë që, si trashëgimtarë të Ymer dhe Sehit Loxhës, janë persona të autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në pajtim me Nenin 452 (1) të KPPPK. Ata, po ashtu, pretendojnë se Gjykata Supreme nuk e ka interpretuar në mënyrë të drejtë Nenin 452 të KPPPK dhe kështu iu ka mohuar atyre të drejtën për të paraqitur ankesë.
17. Për më shumë, parashtresit pretendojnë që rasti i gjykuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë më 1945 ka qenë një rast penal, për shkak se konfiskimi i pronës, në bazë të Ligjit për Veprat Penale kundër Popullit dhe Shtetit (Gazeta Zyrtare 6611 e vitit 1945), është zbatuar vetëm kundër personave të dënuar, dhe që po ashtu, në të njëjtin vendim të gjykatës, vëllezërit Ymer dhe Sehit Loxha janë shpallur (pa procedurë gjyqësore) armiq të popullit dhe se për këto arsye edhe është konfiskuar prona e tyre.
18. Parashtresit, po ashtu, pretendojnë se vetë fakti që vendimi i Gjykatës së Qarkut ka kodin e referencës K.K, konfirmon që, zyrtarisht, vendimi ka qenë i natyrës penale, për shkak se KK përdoret për vendimet mbi konfiskimin penal dhe që domethënia e këtij kodi të referencës është "kriminalna konfiskacija".
19. Ata pohojnë që krimet e kryera nga regjimi komunist janë të ditura mirë, përfshirë ndër të tjera, edhe mohimin e të drejtave individuale për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Prandaj, sipas parashtresve, mohimi i këtyre të drejtave nuk mund të

³ Neni 8 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; Neni 14 (5) i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave Civile dhe Politike dhe Neni 2 (1) i Protokollit 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

përdoret si arsyetim për të mohuar faktin që konfiskimi i pronës kishte të bënte me një rast penal, edhe pse nuk ishte nisur kurrfarë procedure penale kundër vëllezërve Ymer dhe Sehit Loxha në mënyrë që ata të shpallehin armiq të popullit. Sipas pohimit të tyre, fakti i vetëm, i shpalljes së tyre si armiq të popullit në vendimin gjyqësor për konfiskimin e pronës, konfirmon që në atë kohë e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

20. Së pari, Gjykata Kushtetuese vëren që parashtuesit ankohen se nëpërmjet Vendimit Pkl.Nr.21/07, të datës 17 dhjetor 2008, Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë. Ata e kanë paraqitur këtë kërkesë kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Pejë, të datës 23 maj 2006, dhe kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të datës 10 janar 2007, sipas të cilëve kërkesa për rishikimin e procedurës penale para Gjykatës së Qarkut në Pejë në dhjetor 1945 ishte refuzuar. Pretendohet që kjo procedurë penale ka përfunduar me konfiskimin e pronës së Ymer dhe Sehit Loxhës.
21. Në fakt, duket që parashtuesit nuk pajtohen me gjetjet e gjykatave të lartpërmendura për atë se procedurat para Gjykatës së Qarkut më 1945 nuk kanë qenë të natyrës penale, por kanë qenë në lidhje me procedurën për konfiskimin e pronës në bazë të Ligjit për Konfiskimin e Pronës dhe Ekzekutimin e Konfiskimit të vitit 1945 (Gazeta Zyrtare e Federatës Demokratike të Jugosllavisë, NO 40/45, e datës 9 dhjetor 1945).
22. Ata, po ashtu, ankohen që Gjykata Supreme ka keqinterpretuar ligjin dhe që vendimet gjyqësore të kontestuara kanë shkelur të drejtat e tyre për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për një mjet efektiv juridik, siç garantohet me nenet 31 (2) dhe 32 të Kushtetutës, Nenin 2 (1) të Protokollit Nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenin 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
23. Gjykata Kushtetuese përsëritë që nuk e ka për detyrë, në bazë të Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit apo si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e zakonshme. Është detyrë e këtyre të fundit të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
24. Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur dhe që procedurat në përgjithësi, marrë në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në atë mënyrë që t'i sigurojë parashtuesit një gjykim të drejtë (shih ndër burimet e ndryshme, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin e Edwards kundër United Kingdom, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
25. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga parashtuesit, Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë indikacion që procedurat kanë qenë të padrejta apo të njollosura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis* Kërkesën Nr. 53363/99, Vanek kundër Republikës Slloake, Vendimi i GJEDNJ, 31 maj 2005). Gjithashtu, Gjykata Supreme ka dhënë arsye të mjaftueshme se përse nuk ka aprovuar kërkesën e parashtuesve për mbrojtje të ligjshmërisë. Nga kjo rrjedhë që kjo ankesë është e papabazuar dhe duhet të refuzohet.
26. Parashtuesit, po ashtu, kanë kërkuar që Gjykata Kushtetuese të shpallë vendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë të vitit 1945 si të pavlefshëm, përfshirë edhe dënimet që burojnë nga ky vendim.

27. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese thekson që ankesa e parashtruese ka të bëjë me ngjarjet para datës 17 shkurt 2009, që është data kur Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi. Nga kjo del që kërkesa është jashtë afatit kohor, prandaj nuk është në përputhje *ratione temporis* me dispozitat e Kushtetutës dhe ligjit (shih *mutatis mutandis* Asinine kundër Lituaniës, Kërkesa Nr. 41510/98, Aktgjykimet e GJEDNJ, më 6 mars dhe më 6 qershor 2003).
28. Përfundimisht, sa i përket çështjes së kthimit të pronës, Gjykata Kushtetuese i referohet Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe në veçanti Neni 8 (6) që përcakton, ndër të tjera, se "Kosova do t'i trajtojë me prioritet të gjitha çështjet e kthimit të pronave..., siç parashihet me Aneksin VII të kësaj zgjidhjeje". Neni 6 (1) i këtij Aneksi ofron më shumë hollësi për këtë çështje, duke përcaktuar që "...Kosova gjithashtu do të trajtojë çështjet e kthimit të pronës, si çështje me prioritet. Kosova do të krijojë mekanizma të pavarur për formulimin e politikave, kornizave legjislative dhe institucionale për trajtimin e çështjeve të kthimit të pronës ...".
29. Për më shumë, Aneksi XII i Zgjidhjes, në Nenin 2 (Legjislacioni që formalisht duhet të miratohet gjatë ose pas periudhës së tranzicionit⁴) përcakton që Kuvendi duhet të miratojë "si çështje parësore pas përfundimit të periudhës së tranzicionit...", inter alia, "Ligjin për Kthimin e Pronës" (Neni 2.13).
30. Në lidhje me këtë, Gjykata po ashtu i referohet vetë Kushtetutës së Kosovës që përcakton, në Nenin 1.1, që "Kushtetuta në të gjitha dispozitat e saj do të jetë në përputhje me këtë Zgjidhje dhe do të interpretohet në pajtim me këtë Zgjidhje." Mbrojtja e pronës, e garantuar me Nenin 46 të Kushtetutës, duhet të interpretohet nga Gjykata në bazë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.
31. Përfundimisht, Neni 143 i Kushtetutës përcakton që "Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ...".
32. Sa i përket çështjes së kthimit të pronës, këto dispozita nënkuptojnë, inter alia, se Kuvendi i Kosovës ka për obligim, si çështje parësore pas përfundimit të periudhës së tranzicionit (d.m.th., menjëherë pas 26 korrikut 2007), të miratojë një "Ligj për Kthimin e Pronës. Megjithatë, Gjykata thekson që deri më tani një ligj i tillë nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
33. Prandaj, Gjykata iu kujton autoriteteve të Republikës së Kosovës për obligimin e tyre "që të themelojnë një mekanizëm të pavarur për të formuluar kornizën politike, ligjore dhe institucionale për adresimin e çështjeve të kthimit të pronës, siç përcaktohet me Aneksin VII, Neni 6(1) të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, dhe Kuvendi të miratojë Ligjin për Kthim, në pajtim me Nenin 143 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 2(13) të Aneksit XII (Agjenda Legjislative) e Propozimit Gjithëpërfshirës për Kosovën.

⁴ Neni 15 (1) i Propozimit Gjithëpërfshirës përcakton: "Pas hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje, do të parashihet një periudhë kalimtare prej 120 ditëve".

PËR KËTO ARSYE


Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit dhe të Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ky Vendim do t'i komunikohet palëve dhe Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe do të shpallet zyrtarisht në Gazetën Zyrtare; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Dr. Gjyneta Mushkolaj



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani